



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.184**

**30 dhjetor**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 194 datë 10.12.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare” .....	8153
Ligj nr.10 195 datë 10.12.2009	Për ratifikimin e “Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, në pikën e përbashkët të kalimit të kufirit Muriqan/Sukobinë”	8161
Ligj nr.10 196 datë 10.12.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.	8179
Vendim i KM nr.1233, datë 11.12.2009	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë .....	8181

**LIGJ**  
**Nr.10 194, datë 10.12.2009**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN**  
**“PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA**  
**NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare”, bërë në Hagë më 1 shkurt 1971 dhe që ka hyrë në fuqi më 20 gusht 1979, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6364, datë 29.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**

**KONVENTA**  
**PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA**  
**NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE**  
(përfunduar më 1 shkurt 1971  
& hyrë në fuqi më 20 gusht 1979)

Shtetet palë në këtë Konventë,  
*duke dëshiruar* të krijojnë dispozita të përbashkëta, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore të dhëna në vendet e tyre respektive,  
vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të mëposhtme:

**KAPITULLI I**  
**FUSHA E VEPRIMIT TE KONVENTËS**

Neni 1

Kjo Konventë do të zbatohet për vendimet e dhëna në çështjet civile ose tregtare nga gjykatat e shteteve kontraktuese.

Ajo nuk do të zbatohet për vendimet, objekti kryesor i të cilave është të vendosin:

1. Statusin ose kapacitetin e personave apo çështjeve të së drejtës familjare, duke përfshirë të drejtat personale ose financiare dhe detyrimet midis prindërve dhe fëmijëve apo midis bashkëshortëve;

2. Ekzistencën ose përbërjen e personave juridikë apo kompetencave të punonjësve të tyre;
  3. Detyrimet e pensionit ushqimor, për sa kohë që nuk janë përfshirë në nënparagrafin (1) të këtij neni;
  4. Çështje të trashëgimisë;
  5. Çështje të falimentimit, marrëveshjeve ose procedimeve të ngjashme, duke përfshirë vendime që mund të rrjedhin nga kjo dhe që kanë lidhje me vlefshmërinë e akteve të debitorit;
  6. Çështje të sigurimit shoqëror;
  7. Çështje që kanë lidhje me dëmin në çështje familjare.
- Kjo Konventë nuk zbatohet për vendimet në lidhje me pagesën e ndonjë takse doganore, tatimi ose gjobe.

#### Neni 2

Kjo Konventë do të zbatohet për të gjitha vendimet e dhëna nga gjykatat e një shteti kontraktues, pavarësisht nga emërtimi i dhënë nga ai shtet procedimeve që mundësuan vendimin ose të emërtimit të dhënë vetë vendimit si vendim gjyqësor, urdhër ose urdhër ekzekutimi.

Megjithatë, ajo nuk do të zbatohet as për vendimet që urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse dhe as për vendimet e dhëna nga gjykatat administrative.

#### Neni 3

Kjo Konventë do të zbatohet pavarësisht nga kombësia e palëve.

### KAPITULLI II KUSHTET E NJOHJES DHE ZBATIMIT

#### Neni 4

Një vendim i dhënë në një prej shteteve kontraktuese do të ketë të drejtën e njohjes dhe zbatimit në një shtet tjetër kontraktues sipas kushteve të kësaj Konvente:

1. Nëse vendimi është dhënë nga një gjykatë që cilësohet të ketë juridiksion brenda kuptimit të kësaj Konvente, dhe
2. Nëse nuk është më objekt i formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës.

#### Neni 5

Megjithatë, njohja ose zbatimi i një vendimi mund të refuzohet në ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

1. Nëse njohja ose zbatimi i vendimit është në mospërputhje të hapur me politikën publike të shtetit dërgues ose nëse vendimi ka dalë nga procedime në mospërputhje me kërkesat e procesit të përshtatshëm ligjor ose nëse, në rrethana të caktuara, asnjë palë nuk ka pasur mundësi të mjaftueshme për të paraqitur çështjen e saj;
2. Nëse vendimi është marrë me anë të mashtrimit në kuptimin procedural;
3. Nëse procedimet midis palëve të njëjta, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur të njëjtin qëllim:
  - a) janë duke u shqyrtuar para një gjykate të shtetit dërgues dhe ato procedime kanë qenë të parat për t'u ndërmarrë, ose
  - b) kanë dalë në një vendim nga një gjykatë e shtetit dërgues, ose
  - c) kanë dalë në një vendim nga një gjykatë e një shteti tjetër, i cili do të kishte të drejtën e njohjes dhe zbatimit sipas ligjit të shtetit dërgues.

## Neni 6

Pa cenuar dispozitat e nenit 5, një vendim i dhënë në mungesë nuk do të njihet apo zbatohet për sa kohë që pala në mungesë të ketë marrë njoftim për fillimin e procedimeve në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar atij mbrojtjen e procedimeve.

## Neni 7

Njohja ose zbatimi mund të mos refuzohet për arsyen e vetme se gjykata e shtetit të origjinës ka zbatuar një ligj të ndryshëm nga ai që do të kishte qenë i zbatueshëm sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit dërgues.

Megjithatë, njohja ose zbatimi mund të refuzohet nëse, për të arritur vendimin e saj, gjykata e shtetit të origjinës duhet të vendoste një çështje që kishte lidhje me statusin ose kapacitetin e një pale ose të drejtat e tij në çështje të tjera të përjashtuara nga kjo Konventë nga nënparagrafët (1)-(4) të paragrafit të dytë të nenit 1 dhe ka arritur një rezultat të ndryshëm nga ai që do të ishte ndjekur nga zbatimi i asaj çështjeje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit dërgues.

## Neni 8

Pa cenuar këtë rishikim siç kërkohet nga kushtet e neneve paraardhëse, nuk do të ketë rishikim të themelit të vendimit të dhënë nga gjykata e origjinës.

## Neni 9

Në çështjet që kanë lidhje me juridiksionin e gjykatës së shtetit të origjinës, autoriteti dërgues do të jetë i detyruar nga rezultatet e arsyetimit nga provat mbi të cilat ajo gjykatë ka bazuar juridiksionin e saj, për sa kohë që vendimi është dhënë në mungesë.

## Neni 10

Gjykata e shtetit të origjinës do të cilësohet të ketë juridiksion për qëllime të kësaj Konvente:

1. Nëse i pandehuri, në kohën kur kanë filluar procedimet, kishte banesën e tij të përhershme në shtetin e origjinës ose, nëse i pandehuri nuk është person fizik, kishte pasur rezidencën e tij, vendin e tij të korporatës ose vendin e tij kryesor të biznesit në atë shtet;

2. Nëse i pandehuri, në kohën kur kanë filluar procedimet, kishte në shtetin e origjinës një firmë tregtare, industriale ose ndonjë biznes tjetër apo një zyrë lokale dhe ishte thirrur aty në procedimet që kanë lindur nga biznesi i kryer nga kjo firmë ose zyrë lokale;

3. Nëse padia kishte si objekt të saj vendosjen e një çështjeje në lidhje me pasurinë e paluajtshme të ndodhur në shtetin e origjinës;

4. Në rastin e dëmeve ndaj personit ose ndaj pasurisë së luajtshme, nëse faktet që shkaktuan dëmin kanë ndodhur në territorin e shtetit të origjinës dhe nëse autori i dëmit të shkaktuar ishte i pranishëm në atë territor në kohën kur kanë ndodhur ato fakte;

5. Nëse me anë të një marrëveshjeje me shkrim ose me anë të një marrëveshjeje verbale të konfirmuar me shkrim brenda një kohe të arsyeshme, palët kanë rënë dakord për t'i paraqitur juridiksionit të gjykatës së origjinës mosmarrëveshjet që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie specifike të ligjshme, për sa kohë që ligji i shtetit të adresuar nuk do të lejonte këtë marrëveshje për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes;

6. Megjithatë, nëse i pandehuri ka argumentuar themelin, pa sfiduar juridiksionin e gjykatës ose duke bërë rezerva në lidhje me të; ky juridiksion nuk do të njihet nëse i pandehuri ka argumentuar themelin me qëllim që të rezistojë ndaj konfiskimit të pasurisë ose të sigurojë lirinë e tij apo nëse njohja e këtij juridiksioni do të ishte në kundërshtim me ligjin e shtetit dërgues për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes;

7. Nëse personi kundër të cilit kërkohet njohja ose zbatimi, ishte palë paditëse në procedimet në gjykatën e origjinës dhe nuk kishte sukses në ato procedime, përveçse kur njohja e këtij juridiksioni do të ishte në kundërshtim me ligjin e shtetit të adresuar për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes.

#### Neni 11

Gjykata e shtetit të origjinës do të cilësohet të ketë juridiksion për qëllime të kësaj Konvente për të gjykuar një kundërpadi:

1. Nëse ajo gjykatë do të kishte pasur juridiksion për të gjykuar padinë, si një padi kryesore sipas nënparagrafëve (1)-(6) të nenit 10 ose

2. Nëse ajo gjykatë ka pasur juridiksion sipas nenit 10 për të gjykuar padinë kryesore dhe nëse kundërpadia ka lindur jashtë kontratës ose jashtë provave mbi të cilat ishte bazuar padia kryesore.

#### Neni 12

Juridiksioni i gjykatës së shtetit të origjinës nuk ka nevojë të njihet nga autoriteti dërgues në rastet e mëposhtme:

1. Nëse ligji i shtetit dërgues u jep gjykatave të tij juridiksion të posaçëm, për shkak të lëndës së padisë ose në bazë të një marrëveshjeje midis palëve për vendosjen e padisë që ka mundësuar vendimin e huaj;

2. Nëse ligji i shtetit dërgues njeh një juridiksion të posaçëm të ndryshëm për shkak të lëndës së padisë ose nëse autoriteti dërgues e konsideron veten të detyruar sipas ligjit ta njohë këtë juridiksion të posaçëm për shkak të një marrëveshjeje midis palëve;

3. Nëse autoriteti dërgues e konsideron veten të detyruar, sipas ligjit të njohë një marrëveshje me anë të së cilës u jepet juridiksion i posaçëm gjyqtarëve të arbitrazhit.

### KAPITULLI III PROCEDURAT E NJOHJES DHE ZBATIMIT

#### Neni 13

Pala që kërkon njohje ose aplikim për zbatim do të sigurojë:

1. një kopje të plotë dhe origjinale të vendimit;

2. nëse vendimi është dhënë në mungesë, kopjet origjinale ose të njehsuara me origjinalin të dokumenteve të kërkuara, për të vërtetuar se thirrja gjyqësore i është dhënë palës në mungesë ashtu siç duhet;

3. të gjitha dokumentet e kërkuara për të vërtetuar që vendimi përmbush kushtet e nënparagrafit (2) të paragrafit të parë të nenit 4 dhe sipas nevojës, të paragrafit të dytë të nenit 4;

4. për sa kohë që autoriteti dërgues nuk kërkon ndryshe, përkthimet e dokumenteve të referuara më sipër, të certifikuara si të sakta nga një agjent diplomatik ose konsullor ose nga një përkthyes i licencuar apo nga ndonjë person tjetër i autorizuar për këtë në secilin shtet.

Nëse kushtet e vendimit nuk e lejojnë autoritetin dërgues të verifikojë nëse kushtet e kësaj Konvente janë përmbushur, ai autoritet mund të kërkojë riprodhimin e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.

Nuk mund të kërkohet asnjë legalizim apo ndonjë formalitet tjetër i ngjashëm.

#### Neni 14

Procedura për njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja udhëhiqet nga ligji i shtetit dërgues, përveç rasteve kur kjo Konventë nuk parashikon ndryshe.

Nëse vendimi përmban dispozita që mund të ndahen, ndonjëra ose më shumë prej tyre mund të njihen apo zbatohen të ndara nga njëra-tjetra.

#### Neni 15

Njohja ose zbatimi i një vendimi arbitrazhi në lidhje me kostot ose shpenzimet gjyqësore mund të jepet në bazë të kësaj Konvente, vetëm nëse kjo Konventë është e zbatueshme për vendimin në themel.

Kjo Konventë do të zbatohet për vendime që kanë lidhje me kostot ose shpenzimet gjyqësore, edhe nëse këto vendime nuk procedohen nga një gjykatë, me kusht që ato të rrjedhin nga një vendim që mund të njihet ose zbatohet sipas kësaj Konvente dhe se vendimi në lidhje me kostot ose shpenzimet mund të kishte qenë objekt i rishikimit gjyqësor.

#### Neni 16

Një vendim për kostot ose shpenzimet, i dhënë në lidhje me dhënien ose refuzimin e njohjes ose zbatimit të një vendimi, mund të zbatohet sipas kësaj Konvente, vetëm nëse aplikanti në procedimet për njohje ose zbatim është mbështetur në këtë Konventë.

#### Neni 17

Megjithatë, asnjë siguracion, obligacion ose depozitë të emërtuara sipas ligjit të shtetit dërgues, nuk do të kërkohet në bazë të kombësisë ose vendbanimit të aplikantit për të garantuar pagesën e kostove ose shpenzimeve gjyqësore nëse aplikanti, duke qenë një person fizik, ka banesën e tij të përhershme në të ose duke mos qenë person fizik ka një qendër biznesi në një shtet, i cili ka lidhur një marrëveshje shtesë me shtetin dërgues, në përputhje me nenin 21.

#### Neni 18

Një pale që i është dhënë ndihmë ligjore në shtetin e origjinës do t'i jepet kjo ndihmë në përputhje me ligjin e shtetit dërgues në çdo procedim për njohje ose për zbatimin e një vendimi të huaj.

#### Neni 19

Marrëveshjet e bëra në gjykatë gjatë një procedimi në shqyrtim që mund të jetë zbatuar në shtetin e origjinës, do të jetë i zbatueshëm në shtetin dërgues sipas të njëjtave kushte si vendimet që hyjnë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, për sa kohë që ato kushte zbatohen për marrëveshjet.

### KAPITULLI IV PADI TË NJËKOHSHME

#### Neni 20

Nëse dy shtete kanë lidhur një marrëveshje shtesë sipas nenit 21, autoritetet gjyqësore të secilit shtet mund të refuzojnë një padi të paraqitur para tyre ose mund ta shtyjnë këtë padi, kur procedime të tjera midis të njëjtave palë, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur të njëjtin qëllim, janë duke u shqyrtuar në një gjykatë të një shteti tjetër dhe këto procedime mund të rezultojnë në një vendim, të cilin autoritetet e shtetit në të cilin është paraqitur padia e përmendur për herë të parë, do ta njihnin sipas ligjit, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente.

Megjithatë, autoritetet e këtyre shteteve mund të urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse, pavarësisht procedimeve në një vend tjetër.

## KAPITULLI V MARRËVESHJE PLOTËSUESE

### Neni 21

Vendimet e dhëna në një shtet kontraktues nuk do të njihen ose zbatohen në një shtet tjetër kontraktues në përputhje me dispozitat e neneve paraardhëse, përveç rasteve kur të dy shtetet, duke qenë palë në këtë Konventë, kanë lidhur një marrëveshje plotësuese për këtë qëllim.

### Neni 22

Kjo Konventë nuk do të zbatohet për vendimet e dhëna para hyrjes në fuqi të marrëveshjes plotësuese të parashikuar në nenin 21, përveçse kur marrëveshja parashikon ndryshe.

Marrëveshja plotësuese do të vazhdojë të jetë e zbatueshme për vendime në lidhje me të cilat kanë filluar procedimet e njohjes ose zbatimit, para se një denoncim i asaj Marrëveshjeje të hyjë në fuqi.

### Neni 23

Në marrëveshjet plotësuese të referuara në nenin 21, shtetet kontraktuese mund të bien dakord:

1. për të qartësuar kuptimin e shprehjes “çështje civile dhe tregtare”, për të vendosur gjykatat, vendimet e të cilave do të njihen dhe zbatohen sipas kësaj Konvente, për të përcaktuar shprehjen “sigurime shoqërore” dhe për të përcaktuar shprehjen “vendbanim i përhershëm”;
2. për të qartësuar kuptimin e termit “ligj” në shtetet me më shumë se një sistem ligjor;
3. për të përfshirë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente probleme që kanë lidhje me dëmin në çështje familjare;
4. për ta zbatuar këtë Konventë për vendimet që urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse;
5. për të mos zbatuar këtë Konventë për vendime të dhëna gjatë procedimeve penale;
6. për të specifikuar rastet sipas të cilave një vendim nuk është më objekt i formave të zakonshme të rishikimit;
7. për të njohur dhe zbatuar vendimet për të cilat do të sigurohej zbatimi në shtetin e origjinës edhe nëse këto vendime janë ende objekt i formave të zakonshme të rishikimit dhe në këtë rast, për të përcaktuar kushtet, sipas të cilave është e mundur një shtyrje e procedimeve për njohje ose zbatim;
8. për të mos zbatuar nenin 6, nëse vendimi i dhënë në mungesë i është njoftuar palës në mungesë dhe kjo e fundit ka pasur mundësinë të bënte një apel në kohë kundër këtij vendimi;  
8 bis që autoriteti dërgues nuk do të jetë i detyruar nga rezultatet e arsytimit, nga provat mbi të cilat gjykata e shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e saj;
9. për të konsideruar gjykatat e shtetit në të cilin i pandehuri ka pasur “vendbanimin” e tij me juridiksion në përputhje me nenin 10:
10. se gjykata e origjinës do të konsiderohet të kishte juridiksion sipas kushteve të kësaj Konvente, në rastet kur juridiksioni i saj është pranuar nga një Konventë tjetër në fuqi midis shtetit të origjinës dhe shtetit dërgues nëse Konventa tjetër nuk përmban rregulla specifike në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja;
11. se gjykata e origjinës do të konsiderohet të kishte juridiksion sipas kushteve të kësaj Konvente ose kur juridiksioni i saj është pranuar nga ligji i shtetit dërgues në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja ose për arsye të tjera, përveç atyre të parashtruara në nenin 10;
12. për të përcaktuar, për qëllime të zbatimit të nenit 12, bazat e juridiksionit të cilat janë të posaçme për shkak të lëndës së padisë;

13. për të përjashtuar, në rastet kur juridiksioni është bazuar në një marrëveshje midis palëve, zbatimin e nënparagrafit (1) të nenit 12, si dhe për të përjashtuar atë të nënparagrafit (3) të nenit 12;

14. për të rregulluar procedurën për sigurimin e njohjes ose zbatimit;

15. për të rregulluar zbatimin e vendimeve të tjera nga ato që urdhërojnë pagesën e një shume parash;

16. se zbatimi i një vendimi të huaj mund të refuzohet kur ka kaluar një periudhë e specifikuar nga data e saj;

17. për të fiksuar përqindjen e interesit të pagueshëm nga data e vendimit në shtetin e origjinës;

18. për të adaptuar në kërkesat e sistemeve të tyre ligjore listën e dokumenteve të kërkuara nga neni 13, por me objektin e vetëm për t'i mundësuar autoritetit dërgues të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e kësaj Konvente;

19. për të paraqitur dokumentet e referuara në nenin 13 për legalizim ose për një formalitet të ngjashëm;

20. për të devijuar nga dispozitat e nenit 17 dhe për të devijuar nga dispozitat e nenit 18;

21. për t'i bërë të detyrueshme dispozitat e paragrafit të parë të nenit 20;

22. për të përfshirë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente "actes authentiques", duke përfshirë dokumente në lidhje me të cilat mund të sigurohet zbatimi i menjëhershëm dhe për t'i specifikuar ato dokumente.

## KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 24

Kjo Konventë nuk do të cenojë konventat e tjera që kanë lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve në të cilat shtetet kontraktuese janë tashmë palë, për sa kohë që ato shtete nuk kanë lidhur një marrëveshje plotësuese sipas kushteve të nenit 21.

Për sa kohë që nuk është rënë dakord ndryshe, dispozitat e një marrëveshjeje plotësuese të lidhura sipas nenit 21 do të dominojnë mbi kushtet e ndonjë konvente të mëparshme në fuqi midis palëve, të cilat kanë të bëjnë me njohjen dhe zbatimin e vendimeve në shkallën që kushtet e tyre të jenë reciprokisht të mospërputhshme.

### Neni 25

Me ose pa lidhjen e një marrëveshjeje plotësuese sipas nenit 21, shtetet kontraktuese nuk do të lidhin konventa të tjera midis tyre mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, për sa kohë që ato nuk e çmojnë të nevojshme, në veçanti, për shkak të lidhjeve ekonomike ose për aspekte specifike të sistemeve të tyre ligjore.

### Neni 26

Pavarësisht nga dispozitat e neneve 24 dhe 25, kjo Konventë dhe marrëveshjet plotësuese të lidhura në përputhje me nenin 21 nuk do të kenë përparësi mbi konventat e tjera në të cilat shtetet kontraktuese janë ose mund të bëhen palë në fusha të veçanta dhe të cilat përmbajnë dispozita për njohjen dhe zbatimin e vendimeve.

### Neni 27

Kjo Konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe për Qipron, Islandën dhe Maltën.



Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

#### Neni 28

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

#### Neni 29

Çdo shtet që nuk përfshihet në dispozitat e paragrafit të parë të nenit 27 mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për këtë shtet, nëse asnjë nga shtetet, të cilat e kanë ratifikuar atë përpara depozitimit të instrumentit të aderimit, nuk paraqesin ndonjë kundërshtim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të tyre prej kësaj ministrie për këtë aderim.

Në mungesë të një kundërshtimi të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për këtë shtet aderues në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës më të fundit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

#### Neni 30

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet mund të deklarojë shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë do të hyjë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre do të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për territoret e përmendura në këtë zgjerim në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Palët në një marrëveshje plotësuese të lidhur në përputhje me nenin 21 do të vendosin vetë për zbatimin territorial të saj.

#### Neni 31

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë edhe përsa u përket shteteve që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim do të njoftohet të paktën 6 muaj përpara mbarimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar për një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

#### Neni 32

Çdo marrëveshje plotësuese e lidhur në përputhje me nenin 21 do të fillojë të ketë pasojë nga data e përcaktuar në këtë Marrëveshje; një përkthim ose një kopje në gjuhën angleze ose frënge

të kësaj marrëveshjeje plotësuese do t'i komunikohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Çdo shtet kontraktues, pa denoncuar Konventën, mundet të denoncojë një marrëveshje plotësuese ose në përputhje me një dispozitë për këtë gjë në vetë atë marrëveshje ose, nëse kjo marrëveshje nuk e parashikon një gjë të tillë, duke i dërguar një njoftim me shkrim shtetit tjetër për një periudhë gjashtëmujore. Çdo shtet kontraktues që denoncon një marrëveshje plotësuese do t'ia komunikojë këtë edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Pavarësisht nga denoncimi i kësaj Konvente, ai do të vazhdojë të ketë pasoja ndërmjet shtetit denoncues dhe çdo shteti tjetër me të cilin kjo e fundit ka lidhur një marrëveshje plotësuese në përputhje me nenin 21, për sa kohë që kjo Marrëveshje nuk parashikon të kundërtën.

### Neni 33

Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta u njofton shteteve palë të përmendura në nenin 27, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 29, sa më poshtë:

- a) çdo nënshkrim dhe ratifikim të përmendur në nenin 27;
- b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë;
- c) çdo aderim të përmendur në nenin 29 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;
- d) çdo zgjerim të parashikuar në nenin 30 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;
- e) një përkthim ose një kopje në gjuhën angleze ose frënge të marrëveshjeve plotësuese të lidhura në përputhje me nenin 21;
- f) çdo denoncim të parashikuar në nenin 31, paragrafi i tretë dhe në nenin 32, paragrafi i dytë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 1 shkurt 1971 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet njësoj autentike të lidhura në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Qipros, Islandës dhe Maltës.

### LIGJ

Nr.10 195, datë 10.12.2009

## **PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR, NË PIKËN E PËRBASHKËT TË KALIMIT TË KUFIRIT MURIQAN/SUKOBINË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, në pikën e përbashkët të kalimit të kufirit Muriqan/Sukobinë”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6365, datë 29.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### **PROTOKOLL**

#### **NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR NË PIKËN E PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR MURIQAN/SUKOBIN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi (këtej e tutje palët kontraktuese në zbatim të marrëveshjes “Për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi në Muriqan”) këtej e tutje PPKK, bien dakord me qëllimin për të thjeshtëzuar dhe lehtësuar kryerjen e veprimtarive që kanë lidhje me kontrollin e kufirit në PPKK-në.

## Neni 1

### **Fusha e zbatimit**

Protokolli gjen zbatim e të gjitha procedurat e përbashkëta që mundësojnë thjeshtëzimin dhe lehtësimin e kontrollit kufitar në lidhje me kontrollin policor, zhdoganimet, inspektimet fito-sanitare dhe veterinare.

## Neni 2

### **Përkufizime**

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1. Kontrolli i kufirit- kontrolli i kryer në PPKK, në mënyrë që personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat të plotësojnë kushtet për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve kontraktuese të këtij protokoll.
2. Vendi i hyrjes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në hyrje.
3. Vendi i daljes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në dalje.
4. Zona e pikës së përbashkët të kalimit kufitar, këtej e tutje ZPPKK, sipërfaqja e përvijuar në shtojcën 1, e vendosur tërësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku nëpunësit e të dy palëve kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar. ZPPKK përfshin seksionin e rrugës në territorin shqiptar, mjediset, mjediset ndihmëse, si dhe çdo mjedis tjetër të nevojshëm për kryerjen e kontrollit kufitar.
5. Nëpunës-çdo nëpunës shërbimi i policisë kufitare, shërbimit doganor, shërbimit fitosanitar dhe veterinar, si dhe çdo nëpunës i autorizuar nga secila palë.
6. Mallrat - mallrat, mjetet e transportit dhe vlerat materiale që u nënshtrohen rregullave doganore.
7. Parimi me një ndalim - kontrolli i kufirit i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje në të njëjtën kohë ku kryhen të gjitha procedurat, duke përfshirë kontrollin e pasaportës, procedurat doganore, kontrollin veterinar dhe fito-sanitar.
8. Komiteti i përbashkët i ekspertëve – komiteti i përbashkët i ekspertëve, i krijuar (këtej e tutje KPE) sipas nenit 2 të marrëveshjes për hapjen e PPKK-së së përbashkët Muriqan/Sukobin.
9. Administrator – një prej palëve kontraktuese e cila, sipas marrëveshjes mes të dyja palëve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjedisëve dhe pajisjeve të përbashkëta.

### Neni 3

1. Për veprimtaritë e përbashkëta të këtij protokollit, vendndodhja e mjediseve zyrtare do të caktohet në territorin e Shqipërisë brenda ZPPKK, ku kontrolli kufitar i njëkohshëm kryhet nga nëpunësit shqiptarë dhe malazezë. Nëpunësit shqiptarë dhe malazezë kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar në ZPPKK ku janë caktuar mjedise të veçanta zyrtare për ta.

2. Në përputhje me këtë Marrëveshje, palët kontraktuese kanë përcaktuar:

a) Kufijtë e zonës së pikës së përbashkët të kalimit kufitar siç tregohet në shtojcën 1.

b) Procedurat për të kthyer në vendin e origjinës ose në një vend tjetër sipas marrëveshjeve të ripranimit një person të ndaluar, një person nën arrest, një person të cilit i është kufizuar liria ose që i është refuzuar hyrja, si dhe procedurat për transferimin e mallrave të sekuestruara apo provave që shoqërojnë ata në një vendndodhje tjetër zyrtare me qëllimin për të kryer kontrollin kufitar në vendin e tyre në përputhje me shtojcën 2.

3. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët kontraktuese do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me rregulloret e brendshme.

4. Tekstet e shënuara në mjediset zyrtare të përdorura nga nëpunësit e vendit fqinj do të jenë në gjuhët e të dy vendeve, me gjuhën e vendit fqinj të vendosur i pari në radhë.

### Neni 4

Kur marrin masa ose kryejnë kontrolle siç përcaktohen në këtë protokoll, nëpunësit e palëve kontraktuese do të shkëmbejnë informacion dhe do të japin asistencë të përbashkët.

### Neni 5

1. Të gjitha aktet ligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës palë kontraktuese.

2. Veprimtaritë ditore të kryera në ZPPKK nga nëpunësit e Malit të Zi do të konsiderohen si të kryera në territorin e Malit të Zi.

### Neni 6

1. Nëpunësit e secilës palë kontraktuese kanë të drejtën të ndalojnë, të arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e një personi gjatë kontrollit kufitar, por vetëm në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv.

2. Kur merren masa sipas paragrafit 1 të këtij neni, nga nëpunësit e secilës prej palëve kontraktuese, nëpuësi i vendit pritës do të informohet menjëherë.

3. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë mbi vlefshmërinë e rregullave të vendit pritës që kanë të bëjnë me azilin dhe refugjatët.

### Neni 7

1. Në ZPPKK kontrolli kufitar në hyrje është i detyrueshëm. Kontrolli kufitar në dalje është në diskrecionin e vendit të daljes. Nëse kryhen të dy, kontrolli në dalje kryhet i pari.

2. Personat dhe mallrat i nënshtrohen kontrollit kufitar vetëm një herë. Nëse ka dyshime se një person i shpallur në kërkim është në ZPPKK, nëpunësit e vendit të daljes kanë të drejtën të përsërisin kontrollin e kufirit pasi nëpunësit e vendit të hyrjes kanë dhënë pëlqimin e tyre.

3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta.

4. Të dyja palët kontraktuese mund të bien dakord për lehtësimin e kontrollit kufitar dhe të vendosin për standardet minimale që duhet të respektohen, siç përcaktohen në shtojcën përkatëse të këtij protokollit.

## Neni 8

Personat që nuk janë shtetas as të Republikës së Shqipërisë dhe as të Malit të Zi, të cilëve iu është refuzuar hyrja nga nëpunësit e vendit të hyrjes nuk do t'u mohohet e drejta për t'u kthyer në vendin e daljes. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes.

## Neni 9

1. Në rastet e parimit me një ndalim, mallrat mund të sekuestrohen nga nëpunësit e vendit të hyrjes.
2. Në rastet kur kontrollet kryhen në mënyrë të veçantë, nëpunësit e vendit të hyrjes mund të ndalojnë, arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e personave ose të sekuestrojnë mallrat vetëm pasi kontrolli i kufirit të ketë përfunduar nga vendi i daljes dhe vetëm në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.
3. Të hollat dhe letrat me vlerë të seksuestruara nga nëpunësit e të dyja palëve kontraktuese gjatë kryerjes së kontrollit të kufirit, si dhe mallrat e seksuestruara duhet të kthehen në vendet e tyre respektive dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit.

## Neni 10

1. Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese do të kenë një kartë identiteti zyrtare dhe autorizim zyrtar, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj.

2. Karta e identitetit do të ketë një numër të veçantë dhe do të përmbajë titullin e PPKK Muriqan-Sukobin, emrin dhe mbiemrin e personit së bashku me një fotografi, funksionin, dhe numrin zyrtar. Teksti i autorizimit zyrtar dhe karta e identitetit do të shkruhen në të dyja gjuhët. Autorizimi zyrtar dhe karta e identitetit lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shqipërisë. Komandanti i PPKK-së i Malit të Zi duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur homologun e tij shqiptar për çdo ndryshim në personelin e agjencive të kufirit në PPKK.

3. Dispozitat në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk ndalojnë autoritetet policore shqiptare që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të Malit të Zi. Nëse një nëpunësi të Malit të Zi i është refuzuar hyrja në Shqipëri, autoritetet përkatëse të Shqipërisë do të informojnë pa vonesë autoritetet përkatëse të Malit të Zi rreth refuzimit.

4. Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese do të mbajnë uniforma gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bihet dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën policia/doganat, të dukshme në anën e parme dhe të prapme të veshjeve, ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që mund të ndodhin sipas këtij paragrafi.

## Neni 11

1. Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese fqinj do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi kalibri 9 mm me (këtej e tutje armë brezi) nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gaz lotsjellës kur janë në detyrë në ZPPKK.

2. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete. Nëpunësit e Malit të Zi kanë të drejtën të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK. Autoritetet përkatëse shqiptare do të njoftohen për këto masa pa vonesë.

## Neni 12

1. Pajisjet zyrtare të të dy palëve kontraktuese, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me kontrollin e kufirit në ZPPKK, mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre respektivë.

2. Qentë e shërbimit të të dy palëve kontraktuese do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Qentë e shërbimit do të përdoren vetëm për marrjen e masave detyruese ndaj individëve në përputhje me paragrafin 2, neni 11.

3. Për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafët 1 dhe 2, palët kontraktuese do ta informojnë njëra-tjetrën menjëherë nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

## Neni 13

Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

## Neni 14

Mënyra se si do të kryhet kontrolli kufitar në vendndodhjet zyrtare të caktuara për kontroll nga palët kontraktuese, duke përfshirë orët e punës, do të caktohen në shtojcën përkatëse të këtij protokollit siç është rënë dakord nga KPE-ja.

## Neni 15

Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta të PPKK do të miratohen nga KPE-ja dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë mes palëve. Administratori do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e PPKK-së.

## Neni 16

1. Objektet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore ose kufizime ose taksa të tjera. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Letrat, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës palë kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e palës tjetër.

## Neni 17

1. Pala kontraktuese shqiptare, përveç përjashtimit nga pagesa e kuotës, do të lejojë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, të përdorura ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga Mali i Zi dhe do të lejojë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të Malit të Zi.

2. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm në Malin e Zi.

## Neni 18

Shtesat dhe ndryshimet e këtij protokollit, siç është rënë dakord mes palëve, do të hartohen me shkrim dhe do të jenë pjesë përbërëse e këtij protokollit.

## Neni 19

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij protokollit do të zgjidhet nga komiteti i përbashkët i ekspertëve.

2. Nëse KPE-ja nuk do të jetë në gjendje të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët brenda tre muajve, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me bisedime dypalëshe nëpërmjet kanaleve diplomatike të të dy qeverive deri në fund të muajit pasardhës.


## Neni 20

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit me të cilin të dy vendet njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për njohjen e këtij protokollit në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Ky protokoll përfundohet për një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund të denoncojë protokollin, duke paraqitur notë verbale me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Protokollit do të pushojë së ekzistuari 6 muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga pala tjetër.

3. Secila prej palëve mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e këtij protokollit për shkak të rendit publik apo shëndetit publik. Fillimi apo anulimi do t'i komunikohet me shkrim pa vonesë palës tjetër kontraktuese. Pezullimi do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së një njoftimi të tillë.


4. Kjo marrëveshje nënshkruhet më 18.6.2009, në \_\_\_\_\_, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, në gjuhën zyrtare të Malit të Zi dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshesh në interpretimin e protokollit, teksti anglisht do të mbizotërojë.




**HAPESIRA KUFITARE MURIQAN SUKOBIN**




## PLAN VENDOSJA E SHERBIMEVE NË PKKP MURIQAN-SUKOBINE




## ZONA E KONTROLIT



KABINA E KONTROLLIT



TERMINALI I PASAGJEREVE



## Godina

Kritere të përgjithshme	<ul style="list-style-type: none"> <li><b><u>Zona e PPKK</u></b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në hyrje të PKK së përbashkët vendoset tabela sinjalizuese që tregon që është <b>Hapësirë e Kontrollit Kufitar(PPKK Muriqan-Sukobine)</b>.</li> <li>Në distancë rreth 1 km vendoset nga PPKK në të dyja vendet tabela paralajmëruese në gjuhët shqip, malazeze dhe anglisht(dhe anasjelltas), qe tregon se po afroresh në PPKK.</li> </ul>								
	<ul style="list-style-type: none"> <li><b><u>Zona e kontrollit të dokumenteve</u></b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zona e kontrollit është zonë me qarkullim të limituar vetëm për shtetasit dhe mjetet që hyjnë/dalin nëpërmjet kufirit shtetëror.</li> <li>Është kategorikisht e ndaluar qarkullimi i personave dhe parkimi i mjeteve që nuk kanë punë në zonën e kontrollit kufitar.</li> <li>Zona e kontrollit kufitar shënohet me vija kufizuese dhe tregohet me tabela.</li> <li>Ambientet e punës se agjencive të të dy vendeve tregohen me tabela të shkruara në gjuhët shqip, anglisht (dhe anasjelltas).</li> <li>Në kabinat e punës së punonjësve të agjencive që operojnë në kufi të të dy vendeve vendosen mbishkrime dalluese, p.sh. kontrolli i pasaportave, dogana etj.</li> <li>Ne korsitë e kalimit vendosen tabela treguese për këmbësore, autovetura dhe autobusë.</li> <li>Tabelat vendosen sipas drejtimit të lëvizjes duke u bazuar në rekomandimet e përgatitura dhe të pranuar nga të dy vendet për PPKK.</li> </ul>								
	<ul style="list-style-type: none"> <li><b><u>Punonjësi i PPKK</u></b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punonjësit e PPKK mbajnë dokument identifikimi në gjuhët respektive dhe me simbolet e agjencisë që përfaqësojnë. Agjencitë që operojnë në PPKK janë:</li> </ul> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td>1. Policia Kufitare &amp; Migracionit e Shqipërisë</td> <td>1. Policia Kufitare e Malit të Zi</td> </tr> <tr> <td>2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë</td> <td>2. Shërbimi Doganor i Malit të Zi</td> </tr> <tr> <td>3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë</td> <td>3. Shërbimi Veterinar i Malit të Zi</td> </tr> <tr> <td>4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë</td> <td>4. Shërbimi Fito-Sanitar i Malit të Zi</td> </tr> </table>	1. Policia Kufitare & Migracionit e Shqipërisë	1. Policia Kufitare e Malit të Zi	2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë	2. Shërbimi Doganor i Malit të Zi	3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë	3. Shërbimi Veterinar i Malit të Zi	4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë	4. Shërbimi Fito-Sanitar i Malit të Zi
	1. Policia Kufitare & Migracionit e Shqipërisë	1. Policia Kufitare e Malit të Zi								
2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë	2. Shërbimi Doganor i Malit të Zi									
3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë	3. Shërbimi Veterinar i Malit të Zi									
4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë	4. Shërbimi Fito-Sanitar i Malit të Zi									
<ul style="list-style-type: none"> <li><b><u>Kontrolli Kufitar</u></b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrolli kufitar i dokumentacionit të udhëtarëve dhe mjeteve behet në zonën e kontrollit sipas parimit <b><u>të kontrollit me një ndalim</u></b>.</li> <li>Kontrolli kufitar behet i përbashkët dhe i njëkohshëm nga të gjitha agjencitë që operojnë në kufi.</li> <li>Veprimet bëhen sipas detyrave t'j përcaktuara në aktet ligjore dhe n/ligjore të shërbimeve pjesëmarrëse. Çdo agjenci duhet të respektojë dhe të mos ndërhyjë në kompetencat e agjencisë përgjegjëse.</li> <li>Për parregullsitë qe konstatohen, veprimet procedurale kryhen nga personeli i palës qe e konstaton parregullsinë sipas kritereve të përcaktuara në protokollin e Zbatimit.</li> <li>Orari punës në pikën e përbashkët të kalimit të kufirit është 24 ore për udhëtarët.</li> </ul>									

<p><b>Dalja nga Republika e Shqipërisë</b></p>	<p><b>Udhëtarë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b><u>Veprimet</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kur shtetasi shqiptar/i huaj afrohet zonës së kontrollit të Dokumenteve duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi fito-sanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera Inspektimi përkatëse.</li> <li>▪ Në kabinën e përbashkët të kontrollit të dokumenteve paraqet dokumentin e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar. Kontrollori i Policisë Kufitare dhe Migracionit i Shqipërisë bën verifikimin e rregullsisë së pasaportës (së bashku me kolegun e Policisë Kufitare të Malit të Zi). Verifikimi konsiston në : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Elementet mbrojtës e të pasaportës,</li> <li>- Rregullsinë e dokumentit,</li> <li>- Krahason dokumentin me personin që e posedon,</li> <li>- Afatet e dokumentit,</li> <li>- Nëse ka ndërhyrje apo jo,</li> <li>- Shtetasve të huaj i bëhet verifikim i shpejte i ditëve të qëndrimit,</li> <li>- Ne hyrje, nëse shtetasi ka nevojë për vizë ose jo,</li> <li>- Nëse ka vize nëse është e vlefshme brenda afatit.</li> </ul> </li> </ul> <p>• <b>Veprimet që kryhen nga kontrolloret :</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumenti i kontrolluar rezulton i rregullt, kontrollori i palës shqiptare, pas konsultimit paraprak me kolegun e palës malazeze, bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative shqiptare. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon pasaportën kontrollorit të palës Malazeze i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative malazeze.</li> <li>2. Kur personi i paraqitur në kabine rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose të hyrjes në Malin e Zi, pas konsultimit të përbashkët me kolegun malazez, kontrollori shqiptar refuzon daljen nga Republika e Shqipërisë duke kryer evidentimin përkatës në sistem, si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast.</li> <li>3. Kur kontrollori shqiptar, së bashku me atë malazez kane dyshime për ndërhyrje në dokumentin e paraqitur nga ana e udhëtarit, kontrollori shqiptar, thërret përgjegjësën e turnit të palës shqiptare dhe i jep pasaportën për ekzaminim të mëtejshëm në laborator. Pas verifikimit në laborator vazhdohet procedura në baze të rezultatit të verifikimit.</li> </ol>
--	------------------------	---

<p><b>Dalja nga Republika e Shqipërisë</b></p>	<p><u>Autoveture</u></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kur shtetasi shqiptar/i huaj udhëton me autoveture, makina ndalohet në zonën e kontrollit të dokumenteve në vendin e shënuar STOP. Drejtuesi i mjetit duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi fito-Sanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera Inspektimi përkatëse.</li> <li>▪ Pas kësaj i paraqet kontrollorit shqiptar dokumentet e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar (dokumentacionin e vet, të personave që ka në makine, nëse ka) dhe të mjetit me të cilin lëviz.</li> <li>▪ Kontrollori i PKM i Shqipërisë bën verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të personave dhe mjetit (së bashku me kolegun e PK të Malit të Zi).</li> <li>▪ <b>Kontrolli fizik:</b> Oficeret e kontrollit janë gati për të bërë kontrollin në varësi të mjetit të transportit, ose të informacionit përkatës që ka të bëjë me personat, mallrat sensitive etj. Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare (kur ka objekt të punës së tyre). Dokumentet gjatë kontrollit fizik të automjetit i mban kontrollori i PKM-së shqiptare. Me mbarimin e kontrollit fizik kryhen të njëjtat veprime nga përfaqësuesit e dy policive kufitare, këqyrje dokumenteve dhe evidentim të ngjarjes në sistem.</li> <li>▪ Verifikimi konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Dokumentet e personave,</li> <li>○ Dokumentet e mjetit,</li> <li>○ Kontroll fizik të mjetit.</li> </ul> </li> <li>▪ <b>Veprimet që kryhen nga kontrolloret :</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumentet e personave dhe mjetit rezultojnë të rregullta, kontrollori i palës shqiptare bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative shqiptare. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon dokumentacionin kontrollorit të palës malazeze, i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative malazeze.</li> <li>2. Kur personi/mjeti i paraqitur në ZKK rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose të hyrjes në Malin e Zi, pas konsultimit të përbashkët me kolegun malazez, kontrollori shqiptar refuzon daljen nga Republika e Shqipërisë, duke kryer evidentimin përkatës në sistem, si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast.</li> <li>3. Në bazë të vlerësimit të kontrollorit të PKM-së shqiptare, apo vlerësimit të përbashkët të të dy kontrollorëve, bëhet verifikim në rubrikën e INTERPOL-it për mjetet dhe personat. Rezultatet e verifikimit ia bën të njohur edhe homologut malazez.</li> <li>4. Kur gjatë kontrollit gjykohet se makina duhet të kalojë në kontroll të imet, i kërkohet drejtuesit të mjetit që ta drejtojë makinën në godinën e skanerit dhe urës ngritëse. Në këtë godinë kontrolli bëhet nga personeli shqiptar i posaçëm, minimumi 2 persona, me prezencën e homologeve malazezë. <b>Grupi përbehet nga përfaqësues të Policisë Kufitare dhe doganave.</b> Pala shqiptare merr masa për mbikëqyrjen e personave që janë në mjet.</li> <li>5. Kontrolli i bërë evidentohet në librin përkatës.</li> <li>6. Në përfundim të kontrollit, sipas rezultatit të tij, hartohen aktet procedurale, sipas modeleve që ka pala që kërkon kryerjen e kontrollit.</li> <li>7. Kur nga kontrolli nuk rezultojnë të ketë probleme i jepet përparësi në përpunim këtij mjeti.</li> </ol> </li> </ul>
--	--------------------------	---

<p>Dalja nga Republika e Shqipërisë</p>	<p>Autobusë &amp; Kamionë</p>	<p><i>Në korsinë e autobusëve dhe kamionëve, ngjitur me kabinën e kontrollit krijohet një terminal për kontrollin e dokumenteve të udhëtareve, sipas aneksit Nr. 2. Kur një mjet transporti i afrohet zonës së kontrollit kufitar duhet t'i deklarojë doganës mallrat në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv për doganat. në varësi të llojit të mallrave, duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga shërbimi Fito-sanitar, shërbimi veterinar ose shërbime të tjera inspektimi përkatëse.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kur në PKK vijnë autobusë për të kaluar nga Shqipëria për në Malin e Zi, punonjësi i palës Shqiptare merr listën e udhëtareve, dokumentet e tyre, të shoferit dhe stafit tjetër në autobus, dhe kërkon kalimin e tyre në terminalin e posaçëm për kontrollin e pasagjereve që udhëtojnë me autobus në drejtimin HYRJE.</li> <li>▪ Vërtetimi i rregullsisë së dokumentave behet se bashku me punonjës të palës së Malit të Zi.</li> <li>▪ Nga grupi i kontrollit behet kontrolli i mjetit dhe bagazheve të pasagjereve në praninë e drejtuesit të mjetit dhe poseduesit të bagazhit.</li> <li>▪ Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare (kur ka objekt të punës së tyre). Dokumentet gjate kontrollit fizik i mban punonjësi i palës shqiptare, i cili pas përfundimit të tij i hedh në sistem. Pas regjistrimit pasaportat ia jep punonjësit të palës malazeze i cili bën regjistrimin në sistem.</li> <li>▪ Verifikimi konsiston si me sipër.</li> <li>▪ <b>Veprimet që kryhen nga kontrolloret :</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumentet e personave dhe mjetit rezultojnë të rregullta, kontrollori i palës shqiptare bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative shqiptare. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon dokumentat kontrollorit të palës malazeze i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative malazeze. Pasagjeret qëndrojnë në terminal deri në përfundimin e procedurave për kontrollin e autobusit. Pas përfundimit të kontrollit pasagjeret orientohen në drejtimin DALJE për të hipur në autobus.</li> <li>2. Kur një ose me shumë persona, ose mjeti i paraqitur në kabine rezultojnë se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose të hyrjes në Malin e Zi, pas konsultimit të përbashkët me kolegun malazez, kontrollori shqiptar refuzon daljen nga Republika e Shqipërisë duke kryer evidentimin përkatës në sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar për këtë rast. në këtë rast personi/personat e parregullt nuk lejohen të dalin nga RSH, dhe autobusi me pasagjeret e tjerë vazhdon udhëtimin. Nëse automjeti nuk plotëson kushtet e daljes i refuzohet dalja nga Shqipëria dhe hyrja në Malin e Zi.</li> <li>3. <b>Kontrolli fizik i kamionëve.</b> Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrijnë kontrole, objekt i përgjegjësive të tyre, bazuar mbi analizën e riskut.</li> <li>4. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjeti duhet të kalojë në kontroll me të imët, i kërkohet drejtuesit të mjetit që ta drejtojë mjetin në godinën e skanerit dhe urës ngritëse. në këtë godinë kontrolli behet nga personeli shqiptar i posaçëm jo me pak se dy persona, me prezencën e homologeve malazezë. Grupi përbehet nga përfaqësues të Policisë Kufitare dhe doganave. Pasagjeret qëndrojnë në terminal.</li> <li>5. Kontrolli i bere evidentohet në librin e hapur për këtë rast.</li> <li>6. Në përfundim të kontrollit, sipas rezultatit të tij, hartohen aktet sipas modeleve që ka pala që kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezultojnë të ketë probleme i jepet përparësi në përpunim këtij mjeti</li> </ol> </li> </ul>
---	-------------------------------	---



<p><b>Dalja nga Republika e Malit të Zi</b></p>	<p><b>Udhëtar</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kur shtetasi malazet/i huaj i afrohet zonës së kontrollit të dokumenteve duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi fito-sanitar, shërbimi veterinar ose shërbime të tjera inspektimi përkatëse.</li> <li>▪ Në kabinën e përbashkët të kontrollit të dokumentave paraqet dokumentin e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar. Kontrollori i Policisë Kufitare të Malit të Zi bën verifikimin e rregullsisë së pasaportës (së bashku me kolegun e Policisë Kufitare dhe Migracionit i Shqipërisë). Verifikimi konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Elementet mbrojtës të pasaportës;</li> <li>- Rregullsinë e dokumentit;</li> <li>- Krahason dokumentin me personin që e posedon;</li> <li>- Afatet e dokumentit;</li> <li>- Nëse ka ndërhyrje apo jo;</li> <li>- Shtetasve të huaj i bëhet verifikim i shpejte i ditëve të qëndrimit;</li> <li>- Në hyrje, nëse shtetasi ka nevojë për vize ose jo;</li> <li>- Nëse ka vize nëse është e vlefshme brenda afatit.</li> </ul> </li> <li>• <b>Veprimet që kryhen nga kontrolloret :</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumenti i kontrolluar rezulton i rregullt, kontrollori i palës malazeze, pas konsultimit paraprak me kolegun e palës shqiptare, bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative malazeze. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon pasaportën kontrollorit të palës shqiptare i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative shqiptare.</li> <li>2. Kur personi i paraqitur në kabine rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Mali i Zi ose të hyrjes në Shqipëri, pas konsultimit të përbashkët me kolegun shqiptar, kontrollori malazet refuzon daljen nga Republika e Malit të Zi duke kryer evidentimin përkatës në sistem, si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast.</li> <li>3. Kur kontrollori malazet, së bashku me atë shqiptar kanë dyshime për ndërhyrje në dokumentin e paraqitur nga ana e udhëtarit, kontrollori malazet, thërret përgjegjës të turnit të palës malazeze dhe i jep pasaportën për ekzaminim të mëtejshëm në laborator. Pas verifikimit në laborator vazhdohet procedura në bazë të rezultatit të verifikimit.</li> </ol> </li> </ul>
---	-----------------------	---

Dalja nga Republika e Malit të Zi	<u>Autoveture</u>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kur shtetasi malazez/i huaj udhëton me autoveture, makina ndalohet në ZKK, në vendin e shënuar STOP. Drejtuesi i mjetit i paraqet kontrollorit malazez dokumentet e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar(dokumentacionin e vet, të personave qe ka në makine,nëse ka) dhe të mjetit me të cilin lëviz.</li> <li>▪ Kontrollori i PK të Malit të Zi bën verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të personave dhe mjetit(së bashku me kolegun e PKM të Shqipërisë).</li> <li>▪ <b>Kontrolli fizik:</b> Oficeret e kontrollit janë gati për të bërë kontrollin në varësi të mjetit të transportit, ose të informacionit përkatës qe ka të bëjë me personat, mallrat sensitive, etj. Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare(kur ka objekt të punës se tyre). Dokumentat gjate kontrollit fizik të automjetit i mban kontrollori i PKM shqiptarë. Me mbarimin e kontrollit fizik kryhen të njëjtat veprime nga përfaqësuesit e dy policive kufitare, këqyrje dokumentave dhe evidentim të ngjarjes në sistem. Dokumentat gjate kontrollit fizik të automjetit i mban kontrollori i PK malazeze. Me mbarimin e kontrollit fizik kryhen të njëjtat veprime nga përfaqësuesit e dy policive kufitare, këqyrje dokumentave dhe evidentim të ngjarjes në sistem.</li> <li>▪ Verifikimi konsiston në : <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Dokumentet e personave,</li> <li>○ Dokumentat e mjetit,</li> <li>○ Kontroll fizik të mjetit.</li> </ul> </li> <li>▪ <b>Veprimet qe kryhen nga kontrolloret:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumentet e personave dhe mjetit rezultojnë të rregullta, kontrollori i palës malazeze bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative malazeze. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon pasaportën kontrollorit të palës shqiptarë i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative shqiptarë.</li> <li>2. Kur personi/mjeti i paraqitur në ZKK rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Mali i Zi ose të hyrjes në Shqipëri, pas konsultimit të përbashkët me kolegun shqiptar, kontrollori malazez refuzon daljen nga Republika e Malit të Zi, duke kryer evidentimin përkatës në sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast.</li> <li>3. Ne baze të vlerësimit të kontrollorit të PK malazeze, apo vlerësimit të përbashkët të te dy kontrolloreve bëhet verifikimi në rubrikën e INTERPOL-it për mjetet dhe personat. Rezultatet e verifikimit ia bën të njohur edhe homologut shqiptar.</li> <li>4. Kur gjate kontrollit gjykohet se makina duhet të kaloje në kontroll me të imët, i kërkohet drejtuesit të mjetit qe ta drejtoje makinën në godinën e skanerit dhe urës ngritëse. në këtë godine kontrolli behet nga personeli malazez i posaçëm, minimumi 2 persona, me prezencën e homologeve shqiptarë. Grupi përbehet nga përfaqësues të Policisë Kufitare dhe të doganave. Pala malazeze merr masa për mbikëqyrjen e personave qe janë në mjet.</li> <li>5. Kontrolli i bere evidentohet në librin e përkatës.</li> <li>6. Ne përfundim të kontrollit sipas rezultatit të tij hartohen aktet sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit.</li> <li>7. Kur nga kontrolli nuk rezulton të ketë probleme i jepet përparësi në përpunim këtij mjeti.</li> </ol> </li> </ul>
-----------------------------------	-------------------	---

<p>Dalja nga Republika e Malit të Zi</p>	<p><u>Autobuza &amp; Kamionëve,</u></p>	<p><i>Ne korsine e autobuzave &amp; kamionëve, ngjitur me kabinën e kontrollit krijohet një terminal për kontrollin e dokumentave të udhëtareve, sipas Aneksit Nr. 2.</i></p> <p>Kur një mjet transporti i afrohet Zonës së Kontrollit Kufitar duhet t'i deklarohë doganës mallrat në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv për doganat. në varësi të llojit të mallrave, duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi Phyto-sanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera Inspektimi përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kur në PKK vijnë autobusë për të kaluar nga Mali i Zi për në Shqipëri, punonjësi i PK malazeze merr listën e udhëtareve, dokumentat e tyre të shoferit dhe të stafit tjetër në autobus, të mjetit dhe kërkon kalimin e tyre në terminalin e posaçëm për kontrollin e pasagjereve që udhëtojnë në autobus në drejtimin HYRJE.</li> <li>• Vërtetimi i rregullsisë së dokumentave behet së bashku me punonjësin e PKM të Shqipërisë.</li> <li>• Nga grupi i kontrollit behet kontrolli i mjetit dhe bagazheve në praninë e drejtuesit të mjetit dhe poseduesit të bagazhit. Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare (kur ka objekt të punës së tyre).</li> <li>• Dokumentat gjate kontrollit fizik i mban punonjësi i PK malazeze, i cili pas përfundimit të tij i hedh në sistem. Pas regjistrimit pasaportat ia jep punonjësit të PKM së Shqipërisë i cili bën regjistrimin në sistem.</li> <li>• Verifikimi konsiston: vepohet si më sipër.</li> <li>• <b>Veprimet që kryhen nga kontrolloret :</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëse dokumentat e personave dhe mjetit rezultojnë të rregullta, kontrollori i palës malazeze bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative malazeze. Pasi ka kryer këto veprime, ai ia kalon pasaportat kontrollorit të palës shqiptare i cili bën të njëjtin veprim në përputhje me aktet administrative shqiptare. Pasagjeret qëndrojnë në terminal deri në përfundimin e procedurave për kontrollin e autobusit. Pas përfundimit të kontrollit pasagjeret orientohen në drejtimin DALJE për të hipur në autobus.</li> <li>2. Kur një ose më shumë persona, ose mjete i paraqitur në kabine rezultojnë se nuk përmbush kushtet e daljes nga Mali i Zi ose të hyrjes në Shqipëri, pas konsultimit të përbashkët me kolegun shqiptar, kontrollori malazez refuzon daljen nga Republika e Malit të Zi duke kryer evidentimin përkatës në sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast. në këtë rast personi/personat e parregullt nuk lejohen të dalin nga Mali i Zi, dhe autobusi e pasagjeret vazhdojnë udhëtimin. Nëse autobusi nuk plotëson kushtet e daljes i refuzohet dalja nga Mali i Zi dhe hyrja në Shqipëri.</li> <li>3. <b>Kontrolli fizik i kamionëve:</b> Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrojnë kontrolle, objekt i përgjegjësive të tyre, bazuar mbi analizën e riskut.</li> <li>4. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjete duhet të kalojnë në kontroll me të imët, i kërkohet drejtuesit të mjetit që ta drejtojë makinën në godinën e Skanerit dhe Urës Ngritëse. në këtë godinë kontrolli behet nga personeli malazez i posaçëm, jo më pak se dy persona, me prezencën e homologeve shqiptar. Grupi përbehet nga përfaqësues të Policisë Kufitare dhe doganave. Pasagjeret qëndrojnë në terminal.</li> <li>5. Kontrolli i bere evidentohet në librin përkatës.</li> <li>6. Në përfundim të kontrollit sipas rezultatit të tij hartohen aktet sipas modeleve që ka pala që kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezultojnë të ketë probleme i jepet përparësi në përpunim këtij mjete</li> </ol> </li> </ul>
--	---	--

**LIGJ**  
**Nr.10 196, datë 10.12.2009**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 3, pas pikës 39 shtohen pikat 39/1 e 39/2 me këtë përmbajtje:

“39/1. “Certifikata e gjelbër” është dokumenti zyrtar me kohë vlefshmërie të kufizuar, e transferueshme veçmas fizikisht nga energjia elektrike, të cilën e certifikon. Ajo vërteton prodhimin e një sasive të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë apo nga një metodë e kombinuar prodhimi, në të cilën jepen data dhe vendi i prodhimit, centrali gjenerues dhe pronari.

39/2. “Certifikata e garancisë së origjinës” është një dokument zyrtar i transferueshëm, që vërteton prodhuesin, sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e energjive të rinovueshme, centralin elektrik dhe kapacitetin e tij.”.

**Neni 2**

Në nenin 8, pas shkronjës “1” shtohen shkronjat “ll”, “m” e “n” me këtë përmbajtje:

“ll) kualifikon centralet prodhuese të ushqyera nga burime të rinovueshme të energjisë, si dhe certifikon energjinë e prodhuar prej tyre me “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, çka do të shërbejë për plotësimin e detyrimit të shprehur në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji;

m) harton dhe miraton rregulla dhe procedura të veçanta për kualifikimin e centraleve prodhuese, që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, si dhe për certifikimin e energjisë së prodhuar prej tyre me “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, ku përcaktohen:

i) kategoritë e centraleve dhe afatet e vënies së tyre në punë, për përfitimin e certifikatave të origjinës dhe certifikatave të gjelbra;

ii) formula dhe koeficientet llogaritës të sasisë se energjisë elektrike të prodhuar, që përfiton “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”, në funksion të kapacitetit të instaluar dhe të teknologjisë së përdorur;

iii) vlera nominale e certifikatave, e shprehur në MWh;

iv) elemente të tjera të nevojshme për përshatjen e procesit të kualifikimit dhe të certifikimit të energjisë së rinovueshme me atë të vendeve, me të cilat nënshkruhen marrëveshje për njohjen e ndërsjellë të procedurave të kualifikimit dhe të certifikimit;

n) harton dhe miraton formatin e “Certifikatës së gjelbër” dhe të “Certifikatës së garancisë së origjinës”.

### Neni 3

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

#### Neni 39

#### **Burimet e energjive të rinovueshme**

1. Prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike nga burime jo të rinovueshme energjie, me kapacitet mbi 50 MW, janë të detyruar të prodhojnë dhe/ose injektojnë në sistemin elektroenergetik energji elektrike në masën jo më pak se 3 për qind të prodhimit të tyre të përgjithshëm vjetor të vitit pararendës, nga centrale prodhues që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, të certifikuara nga ERE me “Certifikatë të gjelbër” dhe të vëna në punë pas datës 2.11.2000.

2. Për periudhën 2010-2012 kuota e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni do të rritet çdo vit me 0,75 për qind.

3. Detyrimi i mësipërm është i përmbushur nëse ata blejnë sasi të njëjta të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë të burimeve të rinovueshme. Në këtë rast, detyrimi vlerësohet i përmbushur, kur ERE-ja ose institucionet simotra të vendeve nga importohet energjia elektrike kanë një proces të ndërsjellë certifikimi për prodhimin nga burimet e energjive të rinovueshme.

4. Këshilli i Ministrave autorizohet të ndërmarrë nisma nxitëse dhe mbështetëse për ndërtimin e centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike, që do të konsumohet tërësisht brenda vendit.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë mekanizmat e nxitjes së ndërtimit të centraleve, që shfrytëzojnë energjitë e rinovueshme, si dhe të përcaktojë masën e incentivave për ndërtimin e këtyre centraleve.

6. Për centralet prodhuese të energjisë elektrike, që përdorin burime të rinovueshme energjie, të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, prodhimi i të cilave është i destinuar për mbulimin e nevojave të klientëve tariforë dhe që nuk përfitojnë “Certifikatën e gjelbër”, Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me ERE-në, miraton metodologjinë e llogaritjes së tarifave (feed-in tariff) të shitblerjes së energjisë që prodhojnë.”.

### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6366, datë 29.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.1233, datë 11.12.2009**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË SIPËRFAQES SË TRUALLIT TË  
PARKUT “RINIA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të pronës së paluajtshme shtetërore “Lulishte Parku Rinia”, me numër pasurie 7/187, numër kadastral 8380, PQ-11, me numër rendor 619, në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.**

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE .....	240 lekë
KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL .....	410 lekë
KODI I PUNËS .....	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK .....	55 lekë
KODI I FAMILJES .....	270 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE .....	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 30.12.2009  
Doli nga shtypi më 30.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë